

20101503078

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN
E LIGJIT PËR GJYKATA

Neni 1

Në Ligjin për gjykata ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 58/2006 dhe 35/2008), në nenin 10 paragrafi (1) alineja 5 pas fjalës "publicitet" presja shlyhet dhe shtohen fjalet: "dhe transparence".

Neni 2

Në nenin 22 pas fjaleve: "Gjykata Administrative" vihet presje dhe shtohen fjalet: "Gjykata e Larte Administrative".

Neni 3

Në nenin 23 paragrafi (3) pas fjaleve: "me kompetence të zgjeruar" shtohet fjala "detyrimisht".

Neni 4

Pas nenit 25 shtohet nen i ri 25-a, si vijon:

"Neni 25-a

(1) Gjykata e Larte Administrative themelohet dhe e kryen pushtetin gjyqesor në tere territorin e Republikës së Maqedonisë.

(2) Selia e Gjykates së Larte Administrative është në Shkup."

Neni 5

Në nenin 30 paragrafi (2) alinete 1 dhe 7 numri "15 000" zëvendësohet me numrin "50 000".

Neni 6

Në nenin 31 paragrafi (2) alineja 1 numri "15 000" zëvendësohet me numrin "50 000".

Neni 7

Në nenin 34 alineja 5 shlyhet.

Neni 8

Pas nenin 34 shtohet nen i ri 34-a, si vijon:

"Neni 34-a

Gjykata e Larte Administrative është kompetente:

- 1) të vendose për ankesat kundër vendimeve të Gjykates Administrative;
- 2) të vendose për konfliktin e kompetencave ndërmjet organeve të Republikës, ndërmjet komunave dhe Qytetit të Shkupit, ndërmjet komunave të Qytetit të Shkupit dhe për kontestet e ndodhura për konfliktin e kompetencave ndërmjet komunave dhe Qytetit të Shkupit dhe bartesve të autorizimeve publike, nëse kjo është parapare me ligj, nëse me Kushtetute ose ligje nuk është parapare mbrojtje më ndryshe gjyqesore dhe
- 3) të kryejë punë tjera të percaktuara me ligj."

Neni 9

Në nenin 35 paragrafi 1 pika 3 shlyhet.

Pika 4 behet pika 3.

Në piken 5 e cila behet pika 4 pas fjaleve: "gjykate tjetër" vihet presje dhe shtohen fjalet: "konflikt i kompetences ndërmjet Gjykses së Lartë Administrative dhe gjykses tjetër".

Pika 6 behet pika 5.

Neni 10

Pas nenit 36 - a shtohet nen i ri 36 - b, si vijon:

"Neni 36 - b

(1) Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë në afat prej tete ditësh nga miratimi i aktvendimit të plotfuqishëm, aktvendimin e dorezon në Keshillin Gjyqsor Buxhetor.

(2) Në afat prej 15 ditësh pas pranimit të aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, Keshilli Gjyqsor Buxhetor do të kerkojë nga ankuesi ose i autorizuari i tij që të dorezojë të dhëna për llogarinë bankare për pagesën e mjeteve të gjykuara nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë.

(3) Ankuesi është i obliguar që të dhënat nga paragrafi (2) i këtij neni, t'i dorezojë në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

(4) Mosdorezimi i të dhënave për llogarinë nga ana e ankuesit në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni, nuk paraqet pengesë për zbatimin e aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Nëse ankuesi nuk i dorezon të dhënat për llogarinë bankare në afatin e percaktuar me paragrafin (2) të këtij neni, mjetet e percaktuara me aktvendimin nga paragrafi (1) i këtij neni për pagesë, i bart në llogarinë depozituese të Keshillit Gjyqsor Buxhetor.

(6) Keshilli Gjyqsor Buxhetor do t'i bart mjetet e miratuara në llogarinë e ankuesit pas marrjes së të dhënave për llogarinë.

(7) Mjetet e llogarise depozituese nga paragrafi (5) i këtij neni, do të mbesin në dispozicion të ankuesit më së shumti një vit pas depozitimit të tyre. Pas kalimit të këtij afati, nëse ankuesi nuk dorezon të dhëna për llogarinë, mjetet kthehen në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.“

Neni 11

Në nenin 37 paragrafi (1) alineja 1, në fund të fjalise pas fjales "gjykatat" shtohen fjalet: "dhe i shpall në ueb faqen e Gjykses Supreme të Republikës së Maqedonisë".

Në alinene 10 pas fjaleve: "mase disiplinore" vihet pike dhe shtohen fjalet: "në pajtim me ligjin".

Pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Për paragrafet e percaktuar parimore dhe mendimet parimore juridike për ceshtjet me rendesi për sigurimin e unitetit në zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë dorezon raport vjetor të Keshillit Gjyqsor i Republikës së Maqedonisë dhe e shpall në ueb faqen e gjykses."

Neni 12

Në nenin 39 në paragrafin (8) fjalet: "mbledhja e gjyksesve" zevendesohen me fjalet: "mbledhja e pergjithshme e Gjykses Supreme të Republikës së Maqedonisë".

Në paragrafin (11) fjalet: "vendimi nga paragrafet (4), (7) dhe (8)" zevendesohen me fjalet: "vendimi nga paragrafet (4) dhe (7)".

Në paragrafin (12) fjalet: "të paragrafit (9)" zevendesohen me fjalet "të paragrafeve (8) dhe (9)".

Neni 13

Në nenin 42 para fjales "Gjyksesit" shtohet numri "(1)".

Pas paragrafit (1) shtohen shtate paragrafe të rinj (2), (3), (4), (5), (6), (7) dhe (8) si vijojne:

"(2) Neni 15 paragrafi (4) alineja 3 dhe neni 16 të ketij ligji në lidhje me testin psikologjik dhe testin për integritet, zbatohen edhe gjate zgjedhjes së gjykatesve - porote.

(3) Pas zgjedhjes, gjykatesit - porote detyrimisht mbajne trajnim të specializuar, të organizuar nga Akademia për Gjykates dhe Prokurore Publike.

(4) Pas mbarimit të trajnimit nga paragrafi (3) i ketij neni, gjykatesit - porote e japin provimin për trajnimin e mbaruar.

(5) Nese gjykatesi - porot nuk e jep provimin nga paragrafi (4) i ketij neni i pushon funksioni, që me vendim e konstaton Keshilli Gjyqesor i Republikës së Maqedonisë.

(6) Pas mbarimit të provimit nga paragrafi (4) i ketij neni, Akademia për Gjykates dhe Prokurore Publike në afat prej tri ditësh të Keshilli Gjyqesor i Republikës së Maqedonisë dorezon liste të gjykatesve - porote të cilët nuk e kane dhene provimin.

(7) Permbajtja, kohezgjatja dhe realizimi i trajnimit nga paragrafi (3) të ketij neni, percaktohen në programin e specializuar për trajnim të gjykatesve - porote nga ana e Akademisë për Gjykates dhe Prokurore Publike.

(8) Permbajtjen dhe menyren e realizimit të provimit nga paragrafi (4) të ketij, neni i percakton Akademia për Gjykates dhe Prokurore Publike."

Neni 14

Në nenin 43 pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4), si vijon:

"(4) Për gjykates ose gjykates porot nuk mund të zgjidhet personi i cili me anetar të Keshillit Gjyqesor të Republikës së Maqedonisë është në farefisni në vije të drejte ose në vije anesore deri në shkallen e trete ose është bashkeshort i tij."

Neni 15

Në nenin 45 paragrafi (1) alineja 3 pas fjales "aftesi" shtohen fjalet: "për cfare kryhen kontrole shendetesore."

Alineja 4 ndryshohet si vijon:

"- jurist i diplomuar me arsimin e larte të kryer katervjecar në studime juridike me mesatare prej së paku tete ose jurist i diplomuar me 300 kredi të fituara sipas Sistemit Evropian të Transferit të Kredive (SETK), me mesatare prej së paku 8 në secilin nga të dy ciklet e studimeve universitare, ose diplome të nostrifikuar nga fakulteti juridik jashte vendit për 300 kredi të fituara;"

Në alinene 4 lidheza "dhe" zevendesohet me presje.

Në alinene 5 pika zevendesohet me presje dhe shtohen tri aline të reja 6, 7 dhe 8, si vijojne:

"- në menyre aktive ta njohe njerën nga gjuhët zyrtare të Unionit Evropian, prej të cilave detyrimisht gjuhën angleze, që vertetohet me njerën nga certifikatat vijuese të pranuar nderkombetare:

1) TOEFEL (TOEFEL) - së paku 74 poene për dhenie të provimit në forme elektronike nepermjet kompjuterit, jo më të vjeter se dy vite nga dita e leshimit të certifikates;

2) IELTS (IELTS) - së paku 6 poene, jo më të vjeter se dy vite nga dita e leshimit të certifikates;

3) TOLES (TOLES) - së paku nivel të larte (higher level);

4) ILEK (ILEK) - i dhene me sukses së paku B2 (B2) dhe

5) Certificate Kembrixhi - së paku Certificate të pare për anglisht FCE - B2 (First Certificate of English FCE - B2),

- pune praktike me kompjuter dhe

- të gezoje autoritet, të posedoje integritet për kryerjen e funksionit të gjykatesit dhe të posedoje aftesi sociale për kryerjen e funksionit të gjykatesit, për cfare zbatohen teste për integritet dhe teste psikologjike."

Pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"(2) Llojet e nevojshme të kontrolleve shendetesore, formen dhe permbajtjen e testit psikologjik dhe testit për integritet, si dhe nivelin e punes praktike me kompjutere nga paragrafi (1) alinete 3, 7 dhe 8 të ketij neni, i percakton Keshilli Gjyqesor i Republikes së Maqedonise."

Neni 16

Pas nenit 45 shtohet nen i ri 45-a, si vijon:

"Neni 45 - a

(1) Testi psikologjik të cilin e realizon Keshilli Gjyqesor i Republikes së Maqedonise ka për qellim që nepermjet kontrollit të aftesive sociale t'i afirmoje kandidatet për kryerjen e funksionit të gjykatesit.

(2) Testin për integritet të cilin e realizon Keshilli Gjyqesor i Republikes së Maqedonise, bazohet në kodekset ekzistuese etike dhe profesionale për kryerjen e funksionit gjykates dhe ka për qellim kontrollin e vlerave etike dhe morale të kandidatit për kryerjen e funksionit gjykates dhe perbehet prej:

- testit që realizohet me shkrim dhe në menyre anonime, në baze të listes së percaktuar standarde të pyetjeve dhe

- mbledhjes së të dhenave dhe informatave për vlerat etike dhe morale të kandidatit për kryerjen e funksionit gjykates, të marra në menyre juridikisht relevante nga 15 persona të zgjedhur sipas zgjedhjes së rastesishme nga Keshilli Gjyqesor i Republikes së Maqedonise nga lista e 50 personave të propozuar nga kandidati, me së paku arsimim të mesem të kryer katervjecar të cilet e njohin kandidatin së paku tre vite dhe të cilet nuk mund të jene farefis me kandidatin sipas gjakut në vije të drejte dhe anesore deri në shkallen e katert, adoptues dhe i adoptuar dhe farefis sipas krushqise deri në shkallen e dyte.

(3) Keshilli Gjyqesor i Republikes së Maqedonise eshte i obliguar që gjate realizimit të testit psikologjik dhe testit për integritet, të kete kujdes për mbrojtjen e të dhenave personale, autoritetit dhe dinjitetit të kandidatit, në pajtim me ligjin.

(4) Për realizimin e testit psikologjik dhe pjeses së pare të testit për integritet, Keshilli Gjyqesor i Republikes së Maqedonise angazhon persona profesionale nga institucioni i pavarur dhe teresisht i akredituar profesional.

(5) Testi psikologjik realizohet në baze testeve psikologjike të pranuar nderkombetarisht për kryerjen e funksionit të gjykatesit, të cilat realizohen në së paku njerin nga vendet anetare të Unionit Evropian dhe OECD-së."

Neni 17

Neni 46 ndryshohet si vijon:

"(1) Kushte të vecanta për zgjedhje të gjykatesit në gjykaten themelore, gjykaten e apelit edhe në Gjykaten Supreme të Republikes së Maqedonise jane:

- për gjykates të gjykates themelore mund të zgjidhet personi i cili e ka mbaruar trajnimin fillestar në Akademi për Gjykates dhe Prokurore Publike,

- për gjykates të gjykates së apelit mund zgjidhet personi i cili ka pervoje pune prej së paku kater vite stazhi të panderprere gjyqesor si gjykates në gjykaten themelore deri në momentin e paraqitjes për zgjedhje, i cili në vitin e fundit nga ana e Keshillit Gjyqesor të Republikes së Maqedonise eshte vleresuar me noten më të larte pozitive dhe në raport me personat tjere të paraqitur ka fituar numer më të madh të poeneve në pajtim me ligjin, ose gjykates në Gjykaten Administrative ose Gjykaten e Larte Administrative i cili në vitin e fundit nga ana e Keshillit Gjyqesor të Republikes së Maqedonise eshte vleresuar me noten më të larte pozitive dhe në raport me personat tjere të paraqitur ka fituar numer më të madh të poeneve, në pajtim me ligjin dhe

- për gjykates të Gjykates Supreme të Republikës së Maqedonise, mund të zgjidhet personi i cili ka pervoje pune prej së paku gjashte vitesh stazhi të panderprere gjyqesor si gjykates në gjykatën e apelit deri në momentin e paraqitjes për zgjedhje dhe i cili në vitin e fundit nga ana e Keshillit Gjyqesor të Republikës së Maqedonise është vlerësuar me note më të larte pozitive dhe në raport me personat tjere të paraqitur ka fituar numer më të madh të poeneve në pajtim me ligjin, ose gjykates në Gjykatën Administrative ose Gjykatën e Larte Administrative i cili në vitin e fundit nga ana e Keshillit Gjyqesor të Republikës së Maqedonise është vlerësuar me note më të larte pozitive dhe në raport me personat tjere të paraqitur ka fituar numer më të madh të poeneve, në pajtim me ligjin.

(2) Kushte të vecanta për zgjedhje të gjykatesit në Gjykatën Administrative dhe në Gjykatën e Larte Administrative janë:

- për gjykates të Gjykates Administrative mund të zgjidhet personi i cili ka pervoje pune prej së paku kater vitesh stazhi të panderprere gjyqesor si gjykates në gjykatën themelore deri në momentin e paraqitjes për zgjedhje dhe i cili në vitin e fundit nga ana e Keshillit Gjyqesor të Republikës së Maqedonise është e vlerësuar me notën më të larte pozitive dhe në raport me personat tjere të paraqitur ka fituar numer më të madh të poeneve në pajtim me ligjin, ose personi i cili ka pese vite stazh në puneve juridike në organin shtetëror me rezultate të vertetuara në pune ose i cili në vitin e fundit është vlerësuar me note më të larte pozitive në pajtim me ligjin dhe

- për gjykates të Gjykates së Larte Administrative mund të zgjidhet personi i cili ka pervoje pune prej së paku tre vitesh stazh të panderprere gjyqesor si gjykates në Gjykatën Administrative deri në momentin e paraqitjes për zgjedhje dhe i cili në vitin e fundit nga ana e Keshillit Gjyqesor të Republikës së Maqedonise është vlerësuar me note më të larte pozitive dhe në raport me personat tjere të paraqitur ka fituar numer më të madh të poeneve në pajtim me ligjin, ose personi i cili ka gjashte vjet stazh në pune juridike në organin shtetëror me rezultate të vertetuara në pune, ose i cili në vitin e fundit është vlerësuar me note më të larte pozitive, në pajtim me ligjin".

Neni 18

Në nenin 47 pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"(2) Për kryetar të gjykates zgjidhet gjykatesi i cili në dy vitet e fundit nga ana e Keshillit Gjyqesor të Republikës së Maqedonise është vlerësuar me note më të larte pozitive dhe në raport me personat tjere të paraqitur ka fituar numer më të madh të poeneve, në pajtim me ligjin".

Paragrafi (2) behet paragraf (3).

Pas paragrafit (3) i cili behet paragraf (4) shtohet paragraf i ri (5), si vijon:

"(5) Konkurs për zgjedhje të kryetarit të gjykates, Keshilli Gjyqesor i Republikës së Maqedonise shpall dy muaj para skadimit të mandatit të kryetarit ekzistues të gjykatesi. Nga kandidatet e paraqitur të cilet i plotesojne kushtet e nevojshme, Keshilli Gjyqesore i Republikës së Maqedonise më së voni dy muaj pas shpalljes së konkursit zgjedh kryetar të gjykates."

Paragrafi (4) behet paragraf (6).

Neni 19

Në nenin 48 paragrafi (1) fjalet: "e mesme" zevendesohen me fjalet: "e larte", kurse numri "60" zevendesohet me numrin "64".

Neni 20

Në nenin 56 paragrafi (1) alinete 1, 2 dhe 3 shlyhen.

Paragrafi (2) shlyhet.

Në paragrafin (3) i cili behet paragraf (2) numri "4" zevendesohet me numrin "1".

Neni 21

Në nenin 61 paragrafi (3) shlyhet.

Neni 22

Në nenin 67 paragrafi (1) pika zevendesohet me presje dhe shtohen fjalet: "ose derisa zgjat procedura për vepren penale për të cilën është percaktuar denim me burg prej së paku pese vitesh".

Në paragrafin (2) fjalet: "për kohën derisa zgjat hetimi për vepren penale, ose" shlyhen.

Neni 23

Në nenin 68 paragrafi (2) fjalet: "ka të drejte në pergjigje" zevendesohen me fjalet: "jep pergjigje në afatin e percaktuar me ligj".

Neni 24

Në nenin 70 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Kur për shkak të demit të kryer nga paragrafi (1) i këtij neni gjykatesi është shkarkuar, Republika e Maqedonise nepermjet padise do të kerkoje nga gjykatesi i shkarkuar kthimin e shumës së demit të paguar nga paragrafi (1) i këtij neni, në lartësi që do ta percaktoje gjykata në pajtim me ligjin."

Pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Pas shkarkimit të gjykatesit i cili u ka shkaktuar dëm qytetareve ose personave juridike me punë joligjore, Keshilli Gjyqesor i Republikës së Maqedonise në afat prej tete ditësh nga plotfuqishmeria e vendimit për shkarkim, e njofton Avokatine Shtetërore për marrjen e masave nga paragrafi (2) i këtij neni, në kuader të kompetencave të tij të percaktuara me ligj.

Neni 25

Në nenin 72 paragrafi (1) fjalet: "1 shtator" zevendesohen me fjalet: "15 gusht".

Neni 26

Në nenin 73 paragrafi (1) pas alineje 2 shtohet alineja e re 3, si vijon:

"-me mbushjen e moshës 64 vjeçare,"

Neni 27

Në nenin 75 paragrafi (1) alineja 1 ndryshohet si vijon:

" - nese gjate një viti kalendarik Keshilli Gjyqesor i Republikës së Maqedonise ka konstatuar mbajtje joefikase dhe të paazhurnuar të procedurës gjyqesore me fajin e gjykatesit, kur gjykatesi me fajin e tij në më shumë se pese lende i ka tejkualuar afatet ligjore për marrjen e veprimeve të procesit, afatet ligjore për miratimin, shpalljen ose perpilimin e vendimeve gjyqesore, apo nese gjate një viti kalendarik më shumë se 20% nga numri i pergjithshem i lendeve të zgjidhura i janë nderprere ose më shumë se 30% nga numri i pergjithshem i lendeve të zgjidhura i janë ndryshuar,".

Pas alineje 10 shtohet alineja e re 11, si vijon:

"- nese është miratuar vendim nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut me të cilin është percaktuar shkelja e së drejtes për gjykimi të drejte në pajtim me nenin 6 nga Konventa Evropiane për të drejta të njeriut ose është miratuar vendimi i Gjykates Supreme të Republikës së Maqedonise me të cilin është percaktuar shkelja e së drejtes për gjykim në afat të arsyeshem, si rezultat i veprimit të gjykatesit."

Neni 28

Në nenin 76 paragrafi 1 para fjaleve: "Më e rende" shtohet numri "(1)".

Në paragrafin (1) pas pikes 3 shtohet pika e re 4, si vijon:

"4) mosarritje e rezultateve të pritura në pune më shume se tete muaj pa shkaqe të arsyeshme, që e percakton Keshilli Gjyqesor i Republikës së Maqedonise nepermjet numrit të lendeve të zgjidhura, në raport me numrin orientues të lendeve që duhet t'i zgjidhe gjykatesi në muaj, të percaktuar me vendim të Keshillit Gjyqesor të Republikës së Maqedonise."

Pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"(2) Për shkelje disiplinore nga paragrafi (1) pikat 1, 2, 3 dhe 4 të ketij neni, kryetari i gjykates eshte i obliguar që në afat prej tete ditesh nga dita e kryerjes së shkeljes, me shkrim ta njoftoje Keshillin Gjyqesor të Republikës së Maqedonise."

Neni 29

Në nenin 77 fjalet: "mund të shqiptohet" zevendesohen me fjalet: "do të shqiptohet".

Në piken 11 fjalet: "arsim profesional" zevendesohen me fjalet: "trajnim i vazhdueshem"

Pika 12 ndryshohet si vijon:

"nuk e paraqet ose e fsheh gjendjen pronesore ose ndryshimin e gjendjes pronesore në pajtim me ligjin, ose nuk parashtron deklarate për interesa në pajtim me ligjin."

Neni 30

Në nenin 79 paragrafi (1) alineja 6 lidheza "dhe" zevendesohet me presje.

Në alinene 7 pika zevendesohet me lidhezen presje dhe shtohen dy aline të reja 8 dhe 9, si vijojne:

"- nese si kryetar i gjykates nga ana e Keshillit Gjyqesor të Republikës së Maqedonise eshte vleresuar me note negative, në pajtim me ligjin dhe

- nese nuk e njofton Keshillin Gjyqesor të Republikës së Maqedonise për shkeljen e kryer më të rende disiplinore nga ana e gjykatesit, për të cilen ngritet procedure për pergjegjesi disiplinore të gjykatesit, në pajtim me nenin 76 paragrafi (2) të Ligjit për gjykata."

Pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"(2) Më së voni deri më 1 mars në vitin rrjedhes kryetari i gjykates eshte i obliguar që në Keshillin Gjyqesor të Republikës së Maqedonise të dorezoje raport për realizimin e programit për pune për vitin paraprak kalendarik nga paragrafi (1) alineja 7 të ketij neni."

Në paragrafin (2) i cili behet paragraf (3) fjalet: "bazat nga paragrafi (1)" zevendesohen me fjalet: "baza nga paragrafi (1) alineja 3".

Neni 31

Në nenin 83 fjalet: "kujdesi për arsimin dhe ngritjen profesionale të kuadrove" zevendesohen me fjalet: "kujdesi për trajnimin e vazhdueshem të gjykatesve dhe sherbimit gjyqesor".

Pas paragrafit (1) shtohen tre paragraf të rinj (2), (3) dhe (4) si vijojne:

"(2) Për shqyrtimin e parashtresave dhe ankesave të qytetareve për punen e gjykatave të cilat kane të bejne me prolongimin e procedures gjyqesore, ministri i Drejtesise formon komision të perbere prej dy perfaqesuesve nga Ministria e Drejtesise dhe një perfaqesues të caktuar nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonise, për cfare perpilon raport.

(3) Raportin nga paragrafi (2) të ketij neni Komisioni e perpilon dhe e dorezon te Ministria e Drejtesise në afat prej 30 ditesh nga dita e pranimit të parashtreses ose ankeses, kurse Ministria e Drejtesise më së voni në afat prej tri ditesh nga pranimi i raportit e dorezon te Keshilli Gjyqesor i Republikës së Maqedonise.

(4) Menyra e realizimit të shqyrtimit të parashtresave dhe ankesave të qytetareve për punen e gjyqeve që kane të bejne me prolongimin e procedures gjyqesore, rregullohet me akt nenligjor që e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonise me propozim të ministrit të Drejtesise."

Neni 32

Në nenin 84 paragrafi (2) pas fjaleve: "mbajtja e" shtohen fjalet: "evidencave për lendet, si dhe mbajtja e," kurse pas fjaleve: "sistemi informatik në gjykata" vihet presje dhe shtohen fjalet: "incizimi audio-vizuel i debatit".

Neni 33

Në nenin 88 paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

"Kryetarin e gjykates e zevendeson gjykatesi që ai do ta percaktoje me orarin vjetor të punes, i cili në vitin e fundit eshte vleresuar më note më të larte pozitive dhe në raport me gjykatesit tjere ka fituar numer më të madh të poeneve."

Neni 34

Neni 89 ndryshohet si vijon:

"Në rast të shkarkimit ose pushimit të mandatit të kryetarit të gjykates, deri në zgjedhjen e kryetarit të ri Keshilli Gjyqesor i Republikës së Maqedonisë nga radha e gjykatesve të gjykates e cakton ushtruesin e detyres kryetar i gjykates, i cili në vitin e fundit eshte vleresuar me note më të larte pozitive dhe në raport me gjykatesit tjere ka fituar numer më të madh të poeneve."

Neni 35

Në nenin 97 paragrafi (1) fjalet: "ose gjykatesi me autorizimin e vet" zevendesohen me fjalet: "personi pergjegjes për marredhenie me publikun".

Pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"(2) Në gjykatat detyrimisht formohet zyre për marredhenie me publikun".

Paragrafet (2), (3), (4) dhe (5) behen paragrafe (3), (4), (5) dhe (6).

Neni 36

Në nenin 99 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Gjykatat jane të detyruara që vendimet e miratuara në afat prej dy ditesh nga dita e perpilimit dhe nenshkrimit, t'i shpallin në ueb faqen e gjykates, në menyre të percaktuar me ligj."

Paragrafet (3), (4), (5) dhe (6) behen paragrafe (4), (5), (6) dhe (7).

Neni 37

Në titullin e Kreut IX fjala "PROFESIONALE" shlyhet.

Neni 38

Neni 100 ndryshohet si vijon:

"Sherbimin gjyqesor e perbejne nepunesit gjyqesore, personat e punesuar në gjykata të cilet kryejne pune teknike dhe ndihmese dhe policia gjyqesore."

Neni 39

Neni 101 ndryshohet si vijon:

"Statusi, të drejtat, detyrat, pergjegjesite e sherbimit gjyqesor, sistemi i rrogave dhe kompensimeve të rrogave të sherbimit gjyqesor, si dhe menaxhimi me lendet gjyqesore rregullohen me ligj."

Neni 40

Neni 102 ndryshohet si vijon:

"Sherbimi gjyqesor punet e percaktuara me ligj i kryen në pajtim me parimet e ligjshmerise, profesionalizmit, pergjegjesise, efikasitetit, ekonomizmit dhe transparences".

Neni 41

Neni 103 ndryshohet si vijon:

"Nepunesit gjyqesore në kuader të kompetences së vet janë të detyruar që t'u sigurojne qytetareve realizim efikas dhe të ligjshem të lirive të tyre kushtetuese, të drejtave dhe interesave në procedura para gjykatave".

Neni 42

Nenet 104, 105, 106 dhe 107 shlyhen.

Neni 43

Neni 112 ndryshohet si vijon:

"Kompetencat e policise gjyqesore, të drejtat dhe obligimet, punesimi, pergjegjesia disiplinore e pjesetareve të policise gjyqesore dhe ceshtje tjera nga kompetenca e policise gjyqesore, rregullohen me ligj."

Neni 44

Nenet 113, 114, 115, 116, 117 dhe 118 shlyhen.

DISPOZITA KALIMTARE DHE PERFUNDIMTARE

Neni 45

Plotesimi i kushtit për sigurim të mesatares prej së paku 8 për jurist të diplomuar me arsimim të larte të kryer katervjecar të studimeve juridike ose jurist i diplomuar me 300 kredi të fituara sipas Sistemit Evropian të Transferit të Kredive (SETK), me mesatare prej së paku 8 në secilin prej dy cikleve të studimeve universitare, ose diplome të nostrifikuar nga fakulteti juridik jashte vendit për 300 kredi të fituara nga neni 15 paragrafi (2) alineja 1 të ketij ligji, obligimi për dorezimin e certifikates së pranuar nderkombetare për njohjen e gjuhes së huaj nga neni 15 paragrafi (4) alineja 1 të ketij ligji dhe kushti për realizimin e testeve për integritet dhe testeve psikologjike nga neni 15 paragrafi (4) alineja 3 të ketij ligji, do të fillojne të zbatohen nga 1 korriku 2013.

Kushtet e vecanta për zgjedhje të gjykatesit në gjykatat themelore nga neni 17 paragrafi (1) alineja 1 të ketij ligji, do të fillojne të zbatohen nga 1 janari 2013.

Në periudhen nga 1 janari 2012 deri më 1 janar 2013, Keshilli Gjyqesor i Republikës së Maqedonisë 50 perqind nga vendet e percaktuara të lira të gjykatesve për gjykatat themelore, do t'i plotesoje me persona që i plotesojne kushtet sipas nenit 45 të Ligjit për gjykata ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 58/2006 dhe 35/2008) që nuk e kane ndjekur trajnimin fillestar në Akademi për Gjykates dhe Prokurore Publike dhe që kane pervoje pune me rezultate të vertetuara në pune juridike pas dhenies së provimit të jurisprudences mbi tre vite.

Kushtet e vecanta për zgjedhje të gjykatesit në gjykatat e apelit dhe në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë nga neni 17 paragrafi (1) alinete 2 dhe 3 të ketij ligji, do të fillojne të zbatohen nga 1 korriku 2013.

Neni 46

Plotesimi i kushtit për sigurimin e mesatares prej së paku 8 nga neni 15 paragrafi (2) alineja 1 të ketij ligji dhe kushti për njohjen e gjuhes së huaj nga neni 14 paragrafi (4) alineja 1 të ketij ligji, nuk do të zbatohet për kandidatet për gjykates të cilet janë pranuar dhe e kane mbaruar trajnimin fillestar në Akademinë për Gjykates dhe Prokurore Publike në pajtim me Ligjin për Akademinë për Gjykates dhe Prokurore Publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 88/10) dhe për gjykatesit të cilet janë zgjedhur para fillimit të zbatimit të ketij ligji.

Neni 47

Plotesimi i kushtit për sigurimin e arsimit të larte për zgjedhje të gjykatesit - porot nga neni 19 paragrafi (1) të ketij ligji, do të filloje të zbatohet nga 1 janari 2016.

Deri në fillimin e zbatimit të kushtit nga neni 19 paragrafi (1) të ketij ligji në lidhje me paragrafin 1 të ketij neni, gjate zgjedhjes së gjykatesve - porote perparesi do të kene kandidatet me arsim të kryer të larte.

Neni 48

Gjykata e Larte Administrative do të filloje me pune në pajtim me dispozitat e Ligjit për konteste administrative.

Gjate zgjedhjes së pare të gjykatesve në Gjykatën e Larte Administrative, zbatohen kushtet e pergjithshme për zgjedhje të gjykatesve nga neni 45 të Ligjit për gjykata ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 58/2006 dhe 35/2008) dhe kushtet e vecanta nga neni 17 paragrafi (2) alineja 2 të ketij ligji.

Neni 49

Nenet 43 dhe 44 të ketij ligji do të fillojne të zbatohen me fillimin e zbatimit të dispozitave të Ligjit për ndryshimin dhe plotesimin e Ligjit për sherbim gjyqesor.

Neni 50

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tete nga dita e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".